



Mentorimi i studentëve gjatë praktikës pedagogjike

Qëllimi i programit:

Fakulteti i Edukimit ka implementuar projektin "Modernizimi i shkollimit të mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës" përmes programit TEMPUS të financuar nga Bashkimi Europian. Projekti ka synuar reformatin e programeve për shkollimin e mësimdhënësve dhe brenda saj edhe ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në shkollë të cilët mentorojnë studentët gjatë praktikës pedagogjike.

Qëllimi kryesor i trajnimit ka të bëjë me përgatitjen e mësimdhënësve me përvojë në punë që të mentorojnë në mënyrë produktive studentët e fakulteteve të edukimit për të zbatuar në praktikë aspektet teorike të dijeve, shkathtësive dhe vlerave të fituara në fakultet.

Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve:

Mësimdhënësit e nivelit parauniversitar

Rezultatet e programit:

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zhvillojnë shkathtësi të mentorimit
- Shpjegojnë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve mentorë në zhvillimin e mësimdhënësve të rinj
- Identifikojnë kompetencat e domosdoshme të një mentori të mirë
- Reflekojnë mbi procesin e mentorimit të studentëve - mësimdhënës dhe modaliteteve si do të mund të ndihmonin studentët në mënyrë më të mirë
- Demonstronjë shkathtësi për të inkurajuar studentët të angazhohen në praktikat e shkrimit reflektiv në funksion të përmirësimit të cilësisë